REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Nr. 314 Prot

Maliq, më 22.01.2025

Projekt-Vendim -Nr. 8

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE DHE MBULIMIN E SHPENZIMEVE TE VARRIMIT.

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nënpika 1.1, gërma "b",ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", i ndryshuar me ligjin nr. 80/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", neni 6/b pika 2, si dhe ligjit nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", neni 36 roli i bashkisë pika 1,2,3, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Maliq:

I. Të miratojë kriteret mbi dhënien e ndihmave financiare

1. Familjet ose individët në nevojë duhet të paraqesë kërkesën pranë zyrave të shërbimit Social ose Bashkisë Qendër Maliq, shoqëruar me dokumentacionin mbështetës për këërkesën:

- Kopjen e kartës së identitetit të aplikantit
- Çertifikanën familjare
- Kopjen e vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësive për Punë
- Vlerësimin social-ekonomik për çdo aplikues (Njësia Administrative).
- Dokumentacion tjetër që vërtëton gjendjen e rënduar shëndetësore apo social-ekonomike)

2. Familjet ose individët që aplikojnë duhet të përmbushin një ose disa nga kriteret e mëposhtëme:

- Fatkeqësi në familje.
- Kryefamiljar me aftësi të kufizuar në gjendje të rënduar shëndetësore.
- Gra kryefamiljare me fëmijë minorenë në kushte të vështira ekonomike dhe shëndetësore.
- Të moshuar të vetmuar pa mbështetje dhe me probleme shëndetësore dhe ekonomike , me të ardhura të pamjaftueshme
- Raste të paraqitura si emergjencë në nevojë për mbështetje të menjëherëshme (aksidente, braktisje, rsate emergjenca shëndetësore)

II. Të miratojë kriteret mbi mbulimin e shpenzimeve të varrimit

1. Shpenzimet e shërbimit të varrimit kryhen nga njësia bazë e qeverisjes vendore ku individi është i regjistruar.
2. Përfitues të këtij shërbimi janë personat që jetojnë në kushtet e varfërisë, të braktisjes, të mungesës së interesit mes anëtarëve të familjes, ose për të cilët është e pamundur të identifikohen familjarë që bartin detyrimin, sipas pikës 1, të nenit 6 të ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", i ndryshuar me ligjin nr. 80/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit"
3. Administratori i Njësisë përkatëse dhe punonjësi social sigurojnë dokumentacionmin e nevojshëm për këtë shërbim si, akt vdekje, certefikate vdekje, lejë varrimi dhe relacion shpjegues mbi arsyet e përfitimit të këtij shërbimi.
4. Deklarimi i vdekjes bëhet nga personat më të afërt tëfamiljes dhe, në mungesë të tyre ose për personat pa njeri, nga Administratori i Njësisë Administrative ku I ndjeri ka gjendjen civile

III. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor

Konceptoi: Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë E.Petriti

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

BASHKIA MALIQ